

**STATUT**  
**I**  
**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“AGJENCI DOGANORE PEGASO”**

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1.1. Sot, më 21.12.2017 (Njëzetë e një Dhjetor Dymijë e Shtatëmbëdhjetë), ne, themeluesit, krijuam një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“AGJENCI DOGANORE PEGASO” SH.P.K.**
- 1.2. Themelues të shoqërisë janë:
1. **Znj. Alie Kokalari**, e bija e Selfos, e datëlindjes 19/01/1960, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal **G05119061D**.
  2. **Z. Hristo Barka**, i biri i Stefanit, i datëlindjes 28/01/1963, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal **G30128025W**
  3. **Z. Nikollaq Shkurti**, i biri i Vasilit, i datëlindjes 12/02/1968, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal **G80212211J**
  4. **Z. Tedian Loçi**, i biri i Agimit, i datëlindjes 02/07/1985, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal **I50702064D**

**Neni 2**  
**Objekti**

- 2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në të, do të jetë:
- “Agjenci Doganore. Kryerje e procedurave për deklaratat e importit dhe eksportit. Përfaqësim i klientëve pranë Administratës Doganore Shqiptare”.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 99 vjet.

**Neni 4:  
Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: “Dogana Kakavije, ndërtesë 1-katëshe, ndërtesa me Çertifikatë Pasurie me Nr 603276, Kakavije, Gjirokastër”.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
1. **Znj. Alie Kokalari**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  2. **Z. Hristo Barka** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  3. **Z. Nikollaq Shkurti** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  4. **Z. Tedian Loçi** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

**Neni 6  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Ortakët e shoqërisë i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjellta me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues.

- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;

- 9.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

##### **Kërkesa nga ortakët e pakicës**

- 10.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 9 të këtij Statuti.
- 10.2 Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse Administratori nuk përmbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tij.
- 10.3 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, Administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 9 të këtij Statuti.

#### **Neni 11**

##### **Kuorumi**

- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme

- ç) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- gj) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.7 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investimet;
  - ç) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

- 11.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 12** **Marrja e vendimeve**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - dh) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 12.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 13** **Përfshirja nga e drejta e votes**

- 13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një person i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 14 Administrimi**

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si Administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 14.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë të shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

Të dhënat e identifikimit: **Znj. Alie Kokalari**, e bija e Selfos, e datëlindjes 19/01/1960, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal G05119061D.

#### **Neni 15 Kompetencat e Administratorit**

- 15.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisë dhe nënshkruajë Pasqyrat Financiare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në Statut.
- 15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- a) sipas Pasqyrave Financiare vjetore apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që ka vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 16**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 16.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 16.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



- 16.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1,2 dhe 3 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
- 16.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

#### **KREU IV VITI FINANCAR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

##### **Neni 17 Viti Financiar**

- 17.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë Financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 18 Shpërndarja e fitimeve**

- 18.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 18.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 18.3 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, Administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.
- 18.4 Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

## **KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 19 Prishja dhe likuidimi**

- 19.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
  - d) me Vendim të Gjykatës;
- 19.2 Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër". Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 20**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 20.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare."

**Neni 21**  
**Baza Ligjore**

- 21.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 22**  
**Mosmarrëveshjet**

- 22.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

**ORTAKËTE**  
**SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"AGJENCI DOGANORE PEGASO"**

Arën Skopçari  
Armeny  
Heisto Baraka

Nikollag Shkurte  
Tedjan Logi